

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"EGFA OIL " SHPK**

Sot, më datë 08/11/2021, u paraqiten personalisht:

- **Z. Aziz Kosman**, i datëlindjes 05/03/1969, shtetas kosovar, lindur ne Rzhanë dhe banues ne Tiranë. Person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i pashaportes me nr P00401120 dhe Nr. Personal 1004420299.

I cili përpiloi këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare "EGFA OIL" SH.P.K, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

**Forma Ligjore**

Të themeloj Shoqërinë Tregtare " EGFA OIL " SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "AK SWISS COMPANY" SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2**

**Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit " EGFA OIL " SH.P.K dhe me emrin tregtar EGFA OIL . Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

- Tregti me pakice e karburanti, vajra lubrifikant etj
- Bar-restorant, market

**NENI 5**

**Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: **Pikë Karburanti prane Rrugës Nacionale Borizanë, Nr. Pas 354/39 Z.K. 1247, Borizanë, Fushë Krujë.**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

#### **NENI 6**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar është Lekë 100.000 (Njeqind mije leke) dhe zotërohet nga ortaket themelues:

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: Lekë 100.000 (Njeqind mije leke)

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaket themelues.

#### **NENI 7**

Ortaket themelueste Shoqërisë Tregtare " **EGFA OIL** " SH.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Ortaku themelues :	<b>Aziz Kosmann</b>
Numri i kuotave :	<b>1</b>
Numri i pjeseve :	<b>1</b>
Pjesemarrja ne Shoqeri :	<b>100,00 %</b>
Lloji i kontributit:	<b>Ne para</b>
Vlera e kontributit	<b>100,000 ( Njeqind mije) leke</b>

Duke gene se Kapitali themeltar do te depozitohet ne llogarine e Shoqerise e cila do te hapet pas rregjistrimit ne QKB, atehere ortaku vendos qe kjo shume do te paguhet prej tij jo me vone 3 muaj nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB, ne llogarine e shoqerise tregtare.  
Rregullat e pageses se kesaj shume jane parashikuar ne kete Statut.

#### **NENI 8**

##### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

#### **NENI 9**

##### **Administratori/ët**



Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve të cilët zgjidhen për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqërise do te jete :

**Z. Aziz Kosman**, i datëlindjes 05/03/1969, shtetas kosovar, lindur ne Rzhane dhe banues ne Tiranë. Person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i pashaportes me nr P00401120 dhe Nr. Personal 1004420299.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 10**

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 11**

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

#### **NENI 12**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

#### **NENI 13**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues, u gjet sipas vullnetit të tyre dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortaket jane njohes te gjuhes shqipe.

#### **ORTAKET THEMELUES**

**Aziz Kosmann**

